



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.514/04

GJYKATA KOMUNALE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, në kontestin e paditësve M.V. nga Prizreni, me banim të përkohshëm në Beograd-Republika e Serbisë rr. “.....” nr. ... , R.M. nga Beogradi-Republika e Serbisë rr. “.....” nr. .. , D.K. nga Prishtina me banim të përkohshëm në Novi Beograd-Republika e Serbisë rr. “.....” nr. .. , S.S. , V.S. dhe V. S.1, që të gjithë nga Prishtina, me banim të përkohshëm në Beograd rr. “.....” nr. ... , kundër të paditurëve Komuna e Prizrenit, Institucionet e Përkohshme Vetqeverisëse të Kosovës – tani Qeveria e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) me seli në Prishtinë dhe KFOR me seli në Prishtinë, për shkak të kompenzimit të demit, vlera e kontestit 465.000 euro, me datën 24.10.2012, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkespacia e paditësve M.V. nga Prizreni, me banim të përkohshëm në Beograd-Republika e Serbisë rr. “.....” nr. ... , R.M. nga Beogradi-Republika e Serbisë rr. “.....” nr. .. , D.K. nga Prishtina me banim të përkohshëm në Novi Beograd-Republika e Serbisë rr. “.....” nr. .. , S.S. , V.S. dhe V. S.1, që të gjithë nga Prishtina, me banim të përkohshëm në Beograd rr. “.....” nr. ... , me të cilën kanë kërkuar që “të obligohen të paditurit Komuna e Prizrenit dhe Institucionet e Përkohshme Vetqeverisëse të Kosovës – tani Qeveria e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, që në emër të kompenzimit të demit material për shkak të shkatërrimit të objekteve, në mënyrë solidare t’ia paguajnë paditësve shumën e përgjithshme në lartësi prej 465.000 euro, me kamatë ligjore duke e llogaritur atë nga dita e parashtrimit të kësaj padie e deri në pagesën definitive, si dhe t’ia paguajnë shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë”, **si tërësisht e pabazuar.**

II. HUDHET POSHTË si e pa lejuar padia e paditësve M.V. nga Prizreni, me banim të përkohshëm në Beograd-Republika e Serbisë rr. “.....” nr. ... , R. M. nga Beogradi-Republika e Serbisë rr. “.....” nr. .. , D.K. nga Prishtina me banim të përkohshëm në Novi Beograd-Republika e Serbisë rr. “.....” nr. .. , S.S., V.S. dhe V.S.1, që të gjithë nga Prishtina, me banim të përkohshëm në Beograd rr. “R. M.” nr. ... , kundër të paditurit të tretë UNMIK me seli në Prishtinë dhe të paditurit të katërt – KFOR me seli në Prishtinë.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit me datën 09.06.2004, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurëve, përmes të cilës kanë kërkuar që të obligohen të paditurit që në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të shkatërrimit të objekteve, në mënyrë solidare t'ia paguajnë paditësve shumën e përgjithshme në lartësi prej 465.000 euro, me kamatë ligjore duke e llogaritur atë nga dita e parashtrimit të kësaj padie e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia paguajnë shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Duke vepruar konform Ligjit mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisitë nr.03/L-048 (nenet 67 dhe 68 të këtij ligji), respektivisht nenit 25 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë kjo gjykatë me datën 12.04.2011, e pezullon (ndërprenë) këtë çështje juridike kontestimore në afat prej 18 muajsh.

Me parashtrësën nr.1821, të datës 16.10.2012, tani Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Drejtësisë, ka parashtruar përgjigje me shkrim në padi përmes të cilës në tërsi e kanë mohuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazë, me arsyetimin se Qeveria e Kosovës nuk ka legjitimitet pasiv - real për të qenë palë në këtë çështje juridiko-civile, pasi që sipas Rezullutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, marrëveshjes teknike të Kumanovës, e cila është pjesë e Rezolutës së OKB-së nr.1244 dhe Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, përgjegjës për ta garantuar rendin dhe sigurinë në Kosovë, në këtë periudhë e kanë pasur KFOR-ri dhe UNMIK-u. Andaj nga këto arsyeza edhe kanë propozuar hudhjen poshtë të padisë si të palejuar, respektivisht refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazuar. Shpenzimet procedurale nuk i kanë kërkuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, shkresave të tjera të lëndës dhe përgjigjes me shkrim ndaj padisë të të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Drejtësisë, pas kalimit të afatit të pezullimit, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se **kërkesëpadia e paditësve në raport me të paditurën e parë Komuna e Prizrenit dhe të paditurën e dytë Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës – tani Qeveria e Republikës së Kosovës, është e pabazuar, ndërsa padia e paditësve në raport me të paditurin e tretë Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) me seli në Prishtinë, dhe të paditurin e katërt - KFOR me seli në Prishtinë, është e palejuar.**

Kjo ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me kompensimin e dëmit për të cilin paditësit pretendojnë se i është shkaktuar gjatë periudhës së muajve Qershor – Gusht të vitit 1999, kohë kjo kur, bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) në Nju Jork nr.1244, përgjegjës për gjendjen e sigurisë në Kosovë, ka qenë KFOR-i dhe UNMIK-u. Në bazë të Rregullores se UNMIK-ut nr.1991/1, të datës 25.06.1999, (neni 1) është e paraparë se *“i gjithë pushteti legjistativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të*

drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm”.

Gjykata vlerëson se në këtë kohë (peridha kohore Qershor-Gusht 1999), nuk kanë ekzistuar Institucionet e Përkohshme Vetqeverisëse të Kosovës (IPVQ), qoftë në nivel qendror apo atë lokal. Të njëjtat janë themeluar tek në fund të vitit 2000, ku pas mbajtjes së zgjedhjeve të para demokratike në nivel lokal, me datën 28.10.2000, fillimisht ishin formuar organet e pushtetit lokal, e pastaj pas mbajtjes së zgjedhjeve nacionale me 17.11.2001, ishin formuar edhe ato të nivelit qendror. Me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/45, të datës 11.8.2000, mbi Vetqeverisjen e Komunave të Kosovës (neni 1 dhe 2), mes tjerash, parashihet se **“me këtë Rregullore themelohen institucionet e përkohshme për vetëqeverisje autonome dhe demokratike në nivel komunal, si njesi themelore territoriale të qeverisjes lokale të cilat e ushtrojnë tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për pushtetin qendror”**. Në nenin 3 të po kësaj Rregulloreje, në mënyrë taksative parashihen përgjegjësitë e Komunës. Nga kjo, mes tjerash, rezulton edhe përfundimi se nuk ekziston suksesioni juridik në mes të ish komunave dhe komunave të themeluara pas vitit 2000 përmes Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/45. E njëjta gjë vlen edhe për Institucionet e Përkohshme Vetqeverisëse Qendrore, respektivisht Qeverinë e Kosovës, përgjegjësitë e së cilës kanë qenë më afër të përshkruara në Kornizen Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e të cilat institucione qendrore, për herë të parë janë themeluar pas zgjedhjeve qendrore të mbajtura më 17.11.2001.

Duke qenë se paditësit e bazojnë kërkesëpadinë e tyre në kohën para themelimit të Komunave dhe IPVQ-ve, gjegjësisht periudhën në të cilën, siç edhe u cek më lartë, i gjithë pushteti legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor, si dhe ai i sigurisë në Kosovë ushtrohej nga UNMIK-u dhe KFOR-i, stafi i të cilave gëzojnë imunitet dhe privilegje si personel ndërkombëtar, ndërsa të paditurit Komuna e Prizrenit dhe Institucionet e Përkohshme Vetqeverisëse të Kosovës - Qeveria, nuk kanë legjitimacion real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore, ngase siç edhe u cek më lartë, këto institucione janë formuar shumë më vonë nga koha kur paditësve i është shkaktuar dëmi i pretenduar, padia e paditësve në raport me të paditurit Komuna e Prizrenit dhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse – Qeveria e Kosovës, u deshtë te refuzohet si e pabazuar.

Në anën tjetër, me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/47, të datës 18.8.2000, për Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre (neni 2 i kësaj rregulloreje), me tjerash, është paraparë se **“KFOR-i, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor”** e për rrjedhojë edhe nga jurisdikcioni i gjykatave në Kosovë. Me nenin 3 të po kësaj Rregulloreje gjithashtu parashihet se **“UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tyre janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor”**. Përfundimisht, me nenin 5 të kësaj Rregulloreje parashihet imuniteti i personelit të UNMIK-ut dhe të KFOR-it, si dhe kohëzgjatja e këtij imuniteti, nga ku edhe del se UNMIK-u dhe KFOR-i, nuk mund të jenë palë në këtë procedurë, andaj edhe padia e paditësve në raport me të paditurën e tretë (UNMIK) dhe të të katërt (KFOR), u deshtë të hudhet poshtë si e palejuar.

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 399 dhe 391 pika (a), lidhur me nenin 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2, të LPK-së.

GJYKATA KOMUNALE NE PRIZREN
C.nr.514/04, datë 24.10.2012

Procesmbjatësja
D. Qerreti, d.v.

Gjyqtari
Valon Totaj, d.v.

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas pranimit të të njejtit, Gjykatës së Qarkut në Prizren, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.